



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo	
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije	
Ministry of Finance	
Arkiva - Arhiva - Archive	
Nr. i fajeva Org. Jedin. Org. Unit	01
Nr. Prot. Br. Prot.	1449
Datum No. pages:	04.08.2015
Date Datum Date:	
PRISHTINE/A	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave
Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Zyra e Ministrit / Kancelarija Ministra / Cabinet of the Minister

REFERENCË:	
PËR/ZA/TO:	Kryetarët e Komunave Zyrtarët Kryesor Financiar Drejtörët e Drejtive Komunale
CC:	Petrit Popova, Drejtor i Departamentit të Buxhetit Komunal, MF
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Avdullah Hoti, Ministër i Financave
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Qarkorja Buxhetore 2016/02 për Komuna
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	Lokacioni: Kucni: Extension: Data: Datum: Date: 

Të nderuar Kryetarë të Komunave,

Bashkëngjitur me këtë letër, ju lutem gjeni Qarkoren Buxhetore 2016/02 për komuna. Përmes kësaj qarkore ju njoftojmë për strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2016 dhe parashikimet për vitet 2017-2018, bazuar në kufijtë e financimit komunal të dhënë me Qarkoren Buxhetore 2016/01 të datës 14 maj 2015.


Kjo qarkore është nxjerrë në përputhje me kompetencat ligjore të Ministrisë së Financave sipas nenit 20 të LMFPP-së. Udhëzimet e dhëna në këtë qarkore janë në përputhje me kushtet e marrëveshjes së arritur në mes të Qeverisë së Kosovës me Fondin Monetar Ndërkombëtar (Letra e Qëllimit), ku përcaktohen niveli dhe struktura e të hyrave dhe shpenzimeve në kuadër të buxhetit të përgjithshëm të Republikës së Kosovës. Këto kushte janë reflekuar në procesin e rishikimit të buxhetit për vitin 2015, planifikimin buxhetor për vitin 2016, dhe parashikimet afatmesme 2017-2018.

Përveç strukturës së shpenzimeve, kjo qarkore ofron edhe sqarime shtesë për kriteret dhe parametrat e aplikuara në formulat bazë për ndarjen e granteve qeveritare sipas komunave për vitin e ardhshëm fiskal, dhe për periudhën afatmesme. Po ashtu, janë ofruar udhëzime për përmirësimin e klasifikimit kodues buxhetor si parakusht për planifikim më të avansuar strategjik.

Ju lutemi t'ju përmbaheni udhëzimeve të dhëna në këtë qarkore në përgatitjen e propozim-buxhetit për komunën e juaj.

Për informata të mëtejme apo asistencë lidhur me cilindo element të kësaj qarkore, ju lutem kontaktoni analistët buxhetorë në Departamentin e Buxhetit Komunal të Ministrisë së Financave.

Sinqerisht,



Avdullah Hoti

Ministër i Financave



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave
Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance
Zyra e Ministrat / Kancelarija Ministra / Cabinet of the Minister

31.07.2015

Qarkorja Buxhetore 2016/02 për Komuna

1. Struktura e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2016

Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar të ruaj stabilitetin makro-fiskal dhe të realizojë Prioritetet Strategjike përmes objektivave sektoriale afatmesme.

Sipas vendimit të Komisionit të Granteve, të bazuar në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, komunat janë të obliguara që nga granti i përgjithshëm komunal të ndihmojnë financimin e shpenzimeve për sektorin e arsimit dhe shëndetësisë.

Deri në aprovimin e ligjit të ri për paga (që është në përgatitje), organizatave buxhetore nuk ju lejohet të rrisin koeficientët e pagave apo nivelin e pagave në rastin kur ato janë fikse, shtimin e numrit të punëtorëve përtrej kufizimeve buxhetore të dhëna në ligjin e buxhetit si dhe krijimin e entiteteve të reja pa disponueshmëri (zotim) të mjeteve nga buxheti i aprovuar.

Çdo mosrespektim i paragrafit të mësipërm nga organizata buxhetore/institucioni është hyrje në obligim pa mbulesë, dhe rrjedhimisht paraqet shkelje të LMFPP-së dhe Ligjit vjetor të buxhetit. Në rast se paraqiten shkelje të tillë, atëherë përgjegjësia bie mbi zyrtarët të cilët marrin hapa të tillë për shkaktimin e mungesës së mjeteve buxhetore për të paguar shpenzimet e rregullta për paga gjatë vitit fiskal. Qeveria nuk do të ndajë mjete shtesë për mbulimin e këtyre obligimeve të krijuara pa mbulesë nga ana e organizatave buxhetore.

Duhet të respektohen plotësisht dispozitat ligjore me rastin e kërkesës për pagesë të punës pas orarit të rregullt të punës. Në shumë raste, këto shpenzime po e ngarkojnë edhe më tej kategorinë e pagave dhe mëditjeve. Ju sugjerojmë që gjatë vitit fiskal 2016 të keni parasysh dispozitat e Ligjit për Shërbyesit Civil që puna pas orarit të rregullt të kompensohet me ditë të lira.

Sa i përket strukturës së shpenzimeve, masa monetare për paga dhe mëditje do të përfshijë edhe kostot për përvojën e punës, për çdo vit pune nga 0.5% të pagës bazë. Planifikimi i punësimit të shërbysesve civil duhet të bëhet në përputhje me masën monetare në dispozicion për kategorinë ekonomike “*Paga dhe Mëditje*” për vitin 2016.

A.H.

Bazuar në priorititet e Qeverisë, në strukturën e shpenzimeve është ruajtur raporti në mes të shpenzimeve rrjedhëse dhe investimeve kapitale. Megjithatë, brenda shpenzimeve rrjedhëse, janë reduktuar lehtësisht ndarjet për kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere me qëllim të rrijes së ndarjeve për kategorinë mallra dhe shërbime, për të përmbushur kërkosat e parashiturara nga Komunat për të mbuluar obligimet kontraktuale.

Në periudhën afatmesme 2016-2018, Qeveria do të ruajë nivelin e ndarjeve për investime kapitale sipas strukturës së vitit 2015. Për më shumë, kursimet e mundshme të shpenzimeve operative, dhe të hyrat shtesë nga performanca më e mirë arkëtuese, gjatë kësaj periudhe do të orientohen drejt ngritjes së nivelit të investimeve kapitale me karakter zhvillimor.

Gjatë procesit të planifikimit të investimeve kapitale secila organizatë buxhetore duhet fillimisht të financojë me prioritet projektet në vazhdimesi, dhe më pas projektet e reja sipas prioriteteve komunale, përfshirë edhe projektet me bashkëfinancim me Ministritë e linjës apo me Donatorët potencial (gjithnjë, në pajtim me kërkosat për përpunën e strukturës së financimit me tabelat buxhetore).

Analizat përkatëse në fazën e hartimit të buxhetit janë shumë të rëndësishme edhe për projekthin e buxhetit mbi bazën e performancës. Indikatorët e performancës ndihmojnë edhe procesin e raportimit dhe monitorimit të ekzekutimit të buxhetit gjatë vitit fiskal.

Për zbatimin e legjislacionit në fuqi me planifikimin e buxhetit për vitin 2016, komuna e Prizrenit duhet të vazhdoj të financoj shpenzimet përkatëse për Qendrën Historike Kulturore dhe për Fshatin Zym, ndërsa komuna e Rahovecit duhet të financoj shpenzimet përkatëse për Këshillin e Hoçës së Madhe, si vazhdimesi e ndarjeve buxhetore të siguruara me rishikimin buxhetor të vitit 2015 të aprovuar në Kuvendin e Kosovës në muajin korrik 2015.

2. Projeksionet e të hyrave vetanake komunale (THV) për vitin 2016

Me anë të Qarkores Buxhetore 2016/02 për komuna, projeksionet e të hyrave vetanake në krahasim me Qarkoren Buxhetore 2016/01 për komuna ndryshohen si në vijim:

- Projeksi i të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit ulet për 200,000 Euro,
- Projeksi i të hyrave vetanake të Komunës së Prizrenit rritet për 200,000 Euro.

Projeksi i THV dhe shpërndarja e tyre nëpër komunat tjera mbetet i njëjtë me atë të paraqitur në Qarkoren buxhetore 2016/01 për komuna.

Po ashtu, komunat njoftohen se duke filluar nga viti i ardhshëm Ministria e Financave do të krahasoj projeksionet komunale të të hyrave vetanake me projeksionet e Ministrisë së Financave për këto të hyra bazuar në potencialin ekonomik të komunave. Andaj, komunat këshillohen që të ngrisin kapacitetet e parashikimit dhe të inkasimit të të hyrave potenciale.

Tabela 1 e bashkangjitur më poshtë, pasqyron strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2016: numrin e stafit për secilën komunë, masën monetare për paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere, dhe shpenzimet kapitale.

D.H.

Tabela 1. Struktura e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2017-2018

D.K.

3. Klasifikimi i buxhetit sipas kodeve funksionale

Sipas instrukSIONEVE të dhëna në Qarkoren Buxhetore 2016/01 për komuna, autoritetet komunale njoftohen se në buxhetin e vitit 2016 do të bëhet klasifikimi i tërësishëm funksional në fazën e planifikimit buxhetor. Për shpenzimet operative, ky klasifikim do të programohet automatikisht në programin BDMS, ku zyrtarët nuk do të kenë nevojë të bëjnë përgjedhjen e kodeve funksionale. Sistemi do të përcaktojë kodin në pajtim me nën-programin buxhetor.

Për projektet kapitale, zyrtarët komunal duhet të përgjedhin opzionin e kodit funksional që përkon me llojin e projektit, për secilin projekt. Zyrtarët e Departamentit të Buxhetit Komunal në MF do të ofrojnë asistencë përmes një Udhëzuesi për Klasifikimin e Projekteve Kapitale për përgjedhjen e kodit të bashkangjitur në PIP (lidhja në fund të ekranit), tek fusha "funksioni", si dhe përmes ndihmës direkte në përcaktimin e kodeve për projekte.

Aplikimi i këtij lloji të klasifikimit buxhetor, të aplikuar deri tanë vetëm në fazën e raportimit finansiar, mundëson shpalosjen e buxhetit sipas funksioneve publike (p.sh. arsim, mbrojtje sociale, çështje ekonomike, administratë, etj.) dhe ofron infrastrukturën për zhvillimin e një procesi buxhetor të bazuar në priorititetet strategjike komunale.

4. Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor (BPGJ)

Sipas Ligjit për Barazi Gjinore Nr.05/L-020 (2015), të gjitha institucionet e Kosovës janë përgjegjëse përfshirjen e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si një instrument i nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve" (Neni 5.1.5.). Për këtë arsy, organizatat buxhetore duhet të bëjnë të dukshme efektet e shpenzimeve publike në barazinë e grave dhe burrave, djemve dhe vajzave në buxhetin vjetor për vitin 2016. Kjo do të kontribuojnë rritjen e efektivitetit dhe transparencës së menaxhimit të financave publike.

Rekomandohet që çdo organizatë buxhetore të përdor tabelat në Shtojcën II dhe të integrojë ato si një shtojcë në buxhetin vjetor 2016, duke përdorur trendët e kaluara për të informuar shpenzimet e planifikuar.

Tabelat në shtojcën II mund të përdoren për të informuar mbi objektivat specifike, aktivitetet, dhe treguesit për rritjen e barazisë gjinore në sektorë të ndryshëm, në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore. Kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht një rritje në shpenzime, por përdorim më efikas të burimeve ekzistuese dhe / ose shpërndarje më të barabartë të burimeve ekzistuese.

Nëse paraqiten pyetje lidhur me udhëzimet në këtë qarkore, organizatat buxhetore duhet të ndjehen të lira që të konsultohen me analistët e tyre në kuadër të Departamentit të Buxhetit Komunal pranë Ministrisë së Financave (MF).

5. Forumet me autoritetet komunale mbi zhvillimin e procesit buxhetor

Departamenti i Buxhetit Komunal në MF do të organizojë forume me autoritetet komunale lidhur me zhvillimin e procesit buxhetor komunal për vitin 2016-2018. Ndërsa, përmes trajnimeve shtesë do të ofrohen udhëzime dhe module më specifike për zyrtarët e buxhetit komunal rrëth hartimit të buxhetit për secilën nga fazat kyçë, përfshirë aplikimin e sistemeve elektronike BDMS dhe PIP. Prandaj, ju inkurajoj që të vazhdoni me procesin e fuqizimit të

24.

kapaciteteve përkatëse të planifikimit të shpenzimit të parasë publike, me qëllim të masksimizimit të përfitimeve ekonomike nga projektet me interes publik.

6. Dorëzimi i propozim-Buxhetit Komunal për vitin 2016-2018 në MF

Komunat pas aprovimit të Buxhetit për vitin 2016-2018 nga Kuvendet Komunale duhet të dorëzojnë deri më datë 30 shtator 2015 në Departamentin e Buxhetit Komunal në Ministrinë e Financave, dokumentet si në vijim:

- Shkresa përcjellëse bazuar në aprovimin e propozim-buxhetit nga Kuvendi Komunal (nënshkruar nga Kryetari i Komunës);
- Vendimi i Kuvendit Komunal mbi aprovimin e propozim-buxhetit komunal për vitin 2016 dhe parashikimet 2017-2018;
- Tabela 4.1 - plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2016 (kopje e shtypur nga sistemi BDMS, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF);
- Tabela 4.2 - financimi i projekteve kapitale për vitin 2016 dhe projekteve kapitale shumëvjeçare për vitin 2017-2018 (shtypur nga sistemi PIP, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF);
- Tabela 4.3 – plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake (shtypur nga sistemi BDMS, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF).

Shtojca I. Kritereve e aplikuar në formulat për ndarjen e granteve qeveritare

a. Granti i përgjithshëm

Sipas Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049, bazë për kalkulimin e grantit të përgjithshëm është numri i popullsisë (neni 24).

Pas regjistrimit të popullsisë në vitit 2011 dhe publikimit zyrtar të të dhënave nga ASK në muajin dhjetor 2012 (përfshirë vlerësimet e Agjencionit Statistikor të Kosovës për katër komunat minoritare të cilat nuk kanë marrë pjesë në procesin e regjistrimit të popullsisë: Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë veriore), Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë Vendimin Nr.09/121 të datës 27.03.2013 për ndryshimin e Shtojcës 1 sipas nenit 35 të LFPL për aplikimin e numrit të ri të popullsisë.

Sipas këtij vendimi zyrtar është aplikuar numri i ri i popullsisë në formulë për kalkulimin e grantit të përgjithshëm dhe grantit të shëndetësisë për vitin 2016.

b. Granti specifik për arsim

Kalkulimi i grantit të arsimit është bërë duke marrë për bazë numrin e nxënësve të regjistruar dhe kriteret dhe formulat e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ nr.18/2009.

Numri i nxënësve të raportuar nga MASHT dhe aprovuar nga Komisioni i Granteve për vitin 2016 është gjithsej 411,746, ku prej tyre 321,586 janë nxënës para fillor dhe fillor, nxënës shumicë janë 311,533 kurse pakicë janë 10,053 nxënës, dhe 90,160 janë nxënës të shkollave të mesme (nxënës shumicë janë 89,615 kurse pakicë janë 2,545 nxënës).

Numri i shkollave është 900 (me paralele të ndara gjithsej janë 1,325 shkolla), ku prej tyre shkolla për arsimin parafillor dhe fillor janë 740 ndërsa shkolla të mesme janë 160.

Me aplikimin e kritereve të aprovuara nga Komisioni i Granteve dhe bazuar në numrin e nxënësve sipas formulës stafi mësimdhënës për vitin 2016 rezulton në total prej 23,182 norma të plota (17,971 mësimdhënës për arsimin papa fillor dhe fillor, 4,830 mësimdhënës për arsimin e mesëm, 76 mësimdhënës për arsimin special dhe 305 mësimdhënës për gjuhën angleze), kurse stafi për pushimet mjekësore dhe të lehonisë rezulton në total prej 695 norma.

Stafi profesional administrativ dhe ndihmës rezulton në total prej 5,438 (prej nga: 1,250 personel administrativ për shkollat fillore, 361 personel administrativ për shkollat e mesme, 3747 personel ndihmës dhe 80 staf për shërbim profesional).

Në vijim gjeni të bashkangjitur parametrat/kriteret e aprovuara nga Komisioni i Granteve (sipas Udhëzimit Administrativ nga MASHT nr.18/2009) kriterë këto të aplikuara në kalkulimin e Grantit specifik për arsim për vitin 2016 si vijon:

- a) Numri i nxënësve të regjistruar dhe të raportuar nga MASHT me datë 25.02.2015 (total 411,746 nxënës);
- b) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit shumicë 1:21.3;
- c) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit pakicë 1:14.2;
- d) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin parashkollar 1:12;

- e) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin e mesëm profesional për nxënësit shumicë 1:17.2, dhe për nxënësit pakicë 1:11.5;
- f) Raporti nxënës-mësimdhënës për zonat malore 1:14.2;
- g) Kalkulimi për stafin mësimdhënës të gjuhës angleze për klasën I dhe II;
- h) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 630 nxënës 1 staf në arsimin para fillor dhe fillor (bazuar në Udhëzimin administrativ nr.18/2009 të MASHT) ;
- i) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 470 nxënës 1 staf në arsimin e mesëm (bazuar në Udhëzimin administrativ nr.18/2009 të MASHT);
- j) Kalkulimi për stafin ndihmës për 170 nxënës 1 staf (pastrues) si dhe 1 staf për shkollë (roje) bazuar në Udhëzimin administrativ nr.18/2009 të MASHT;
- k) Shërbimi profesional (pedagog) nga 4 për 7 komunat e mëdha dhe nga 2 për të gjitha komunat tjera (bazuar në vendimet e mëparshme të Komisionit të Granteve);
- l) Kalkulimi i pagave për stafin mësimdhënës është bërë duke u bazuar në pagat mesatare sipas niveli para fillor, niveli fillor dhe niveli i mesëm;
- m) Kalkulimi i pagave për stafin profesional administrativ dhe ndihmës është bërë duke u bazuar në pagat mesatare për personelin administrativ, personelin teknik dhe ndihmës;
- n) Kalkulimi i kostos për përvojën e punës (8 vite).

Shtojca II: Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor (BPGJ)

Tabela 1. Numri i punëtorëve në Organizatën Buxhetore përkatëse
[Emri i Institucionit]

Viti	Numri total i stafit	Numri i stafit që janë gra	Numri i stafit që janë burra	Paga dhe mëditje /shuma për Gra	Paga dhe mëditje /shuma për Burra
2014					
2015					
2016					

Tabela 2. Planifikimi për vitin 2016 - Nivelet e pagave në Organizatën Buxhetore
[Emri i Institucionit]

Nivelet e pagave	Numri total i stafit në nivele të pagave	Numri i burrave	Shuma e shpenzuar për burra	Numri i Grave	Shuma e shpenzuar për gra
201-400					
401-600					
600+					

Tabela 3. Numrat e përfituesve të subvencioneve apo edhe të shërbimeve të ofruara nga organizata buxhetore të drejtoreve përkatëse (ku është e aplikueshme)
Emri i Institucionit : Emri i Shërbimit/Subvencionit]

Viti	Buxheti total i shërbimit /subvencioni të caktuar	Numri total i përfituesve	Numri i përfituesve gra	Numri i përfituesve burra	Buxheti për gra	Buxheti për burra
2014						
2015						
2016						